

Abstrakt

Synimi i këtij punimi me titull: Përgjegjësia politike dhe penale e Presidentit- aspektet krahasuese, ka për qëllim shtjellimin e rolit dhe pozitën kushtetuese të Presidentit, duke analizuar Kushtetutat e Shteteve, lidhur me kompetencat dhe rolin e fuqishëm të Presidentit, të secilit shtet dhe njëkohësisht duke sqaruar raportin mes Presidentit, Qeverisë dhe Kuvendit ngase Presidenti luan rol shumë të rëndësishëm me veprimet të ndërmarra të tij/saj që janë të përcaktuar me Kushtetutat të Shteteve përkatëse, dhe njëkohësisht rolin e Kuvendit lidhur me propozimin për shkarkimin e Presidentit në rastin e shkeljes së dispozitave Kushtetues.

Përdorimi i metodave normative – krahasimore, në analizimi dhe sçarimi i Kushtetutave të shteteve dhe Kodeve Penale, në lidhje me përcaktimin e dispozitave ligjore për bartjen e përgjegjësinë politike dhe penale të Presidentit, dhe njëkohësisht duke bërë krahasimin mes shteteve me sistem parlamentar dhe presidencial, ku dallimet janë shumë të mëdha mes këtyre dy sistemeve, duke nisur nga ushtrimi i kompetencave si dhe pozita kushtetuese në rastin e shkeljes së dispozitave kushtetutes, si dhe çështjen e imunitetit nga ndjekja penale, kryrjen e veprave penale dhe kundërvajtjes ku është përcaktuar në mënyrë decidive në shtetet me sistem presidencial siç është SHBA, ndërsa në atë gjysmë-presidencial siç është Franca vetëm gjatë ushtrimit të mandatit nuk mbanë asnjë përgjegjësi, ku pas përfundimit të mandatit procedurat e pezulluar riaktivizohen.

Poashtu shkelja e dispozitave kushtetuese nga ana e Presidentit, në lidhje me ushtrimin e detyrave dhe përgjegjesisë më tepër është e rregulluar në aspektin politik, në shtetet me sistem parlamentar, ndërsa lidhur me përgjegjësinë penale pothuajse fare pak, është kushtuar rëndësi në rregullimin e kësaj çështje që e bartë këtë përgjegjësi një nga institucionet më të fuqishme të çdo shteti. Rëndësia e këtij punimi është fokusuar edhe në analizimin e rasteve praktike të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të shteteve përkatëse, për mënyren e interpretimit të tyre dhe mënyren e rregullimit të dispozitave kushtetutese, në lidhje me shkarkimin dhe bartjen e përgjegjësisë politike si dhe rregullimin e përgjegjësisë penale të përcaktuar me Kod Penal ku pothuajse është prekur fare pak njëkohësisht duke bërë krahasime mes shteteve të ndryshme në lidhje me përgjegjësinë politike dhe penale të Presidentit.